

VENDIM

Nr.392, datë 8.4.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME INSTITUCIONET SHTETËRORE DHE ENTET PUBLIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15 pika 8, e 18 pika 2, të ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullore “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

RREGULLORE

PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME INSTITUCIONET SHTETËRORE DHE ENTET PUBLIKE, ROLIT TË AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM SI DHE NORMA TË POSAÇME PROCEDURALE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për:

- a) marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike;
- b) procedurat dhe kriteret e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë, si dhe për pagesën e tyre;
- c) rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq të avokatëve të shtetit pranë ministrive, për procedurat e posaçme për ushtrimin e aktivitetit të avokatëve të shtetit dhe për rolin e avokatëve të shtetit në gjykim;
- ç) rastet dhe çështjet e ushtrimit të këshillimit të institucioneve;
- d) kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes prej Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit tek organi i interesuar i administratës;
- dh) çështjet ekonomike dhe shpenzimet e procesit.

Neni 2

Strukturat e Avokaturës së Shtetit garantojnë njësimin e praktikës juridike, pavarësinë profesionale dhe autonominë teknike, si dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore për këshillimin e drejtë, mbrojtjen dhe përfaqësimin sa më të mirë të interesave publike.

KREU II

MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME INSTITUCIONET SHTETËRORE DHE ENTET PUBLIKE

Neni 3

Dhënia e asistencës juridike

Avokatura e Shtetit jep asistencë juridike në formën e këshillimit dhe të përfaqësimit për institucionet shtetërore nëpërmjet:

- a) ofrimit të shërbimit këshillimor sipas parashikimeve ligjore;

- b) përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave pasurorë;
- c) mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit në procedimin penal;
- ç) unifikimit të praktikës juridike;
- d) ndërmjetësimit për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;
- dh) ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit.

Neni 4

Refuzimi i dhënies së asistencës juridike

1. Avokatura e Shtetit nuk jep asistencë juridike në rastet e mëposhtme:

- a) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve të administratës publike;
- b) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve të qeverisjes vendore, kur asistenca juridike ofrohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme midis Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore;
- c) në çështjet gjyqësore ndërmjet organeve të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore për organet e qeverisjes vendore, pavarësisht nëse ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve vendore mund të ketë një marrëveshje të posaçme për ofrimin e asistencës juridike.

2. Avokati i shtetit/zyra e avokaturës së shtetit e caktuar për ndjekjen e një çështjeje të tillë, kur konstaton se gjendet në një prej rasteve të ndaluara, njofton menjëherë me shkrim Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe pezullon dhënien e asistencës juridike.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit vlerëson dhe vendos nëse rasti konkret përfshihet në rastet e ndaluara, si dhe vendos nëse është rasti që përfaqësimi t'u ofrohet vetëm organeve qendrore të administratës publike. Ai ia njofton menjëherë vendimin e tij organit procedues dhe organit të interesuar që i ka kërkuar asistencë juridike, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme për garantimin e të drejtës së mbrojtjes.

Neni 5

Integrimi organizativ dhe koordinimi

1. Çdo ministri, pranë së cilës emërohet avokat shteti, duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme, si dhe mbështetjen materiale për funksionimin normal të strukturës së Avokaturës së Shtetit në selitë përkatëse.

2. Çdo ministri, pranë së cilës emërohet avokat shteti, duhet të përgatisë një raport vjetor drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit lidhur me shkallën e dhënies së asistencës nga ana e Avokaturës së Shtetit. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në raportimin vjetor drejtuar Ministrit të Drejtësisë, referon në lidhje me shkallën e asistencës dhe nivelin e këshillimit që u është dhënë institucioneve shtetërore dhe enteve publike.

Neni 6

Detyrimi për bashkëpunim

1. Çdo institucion shtetëror dhe ent publik, të cilit i ofrohet asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit, duhet të ofrojë bashkëpunimin që do të kërkohet për të bërë efektiv funksionin e Avokatëve të Shtetit.

2. Detyrimi për bashkëpunim, kryesisht përfshin vënien në dispozicion të dokumentacionit, sqarimeve dhe informacioneve të nevojshme për shqyrtimin e çështjes, hartimin e raporteve lidhur me aktet ose veprimet që cenojnë interesat e institucioneve shtetërore dhe enteve të asistuar nga Avokatura e Shtetit. Ky detyrim përmbushet prej tyre brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës me shkrim nga avokati i shtetit dhe synon t'i sigurojë avokatit të shtetit respektimin e afateve ligjore apo të afateve të caktuara nga organet proceduese për kryerjen e veprimeve procedurale.

3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, Avokatura e Shtetit merr parasysh udhëzimet e dhëna, në çdo rast me shkrim, nga organi apo enti i interesuar, përveç rasteve kur ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi ose interesin publik.

4. Në rast se nga organet e administratës publike nuk respektohet detyrimi për bashkëpunim, Avokatura e Shtetit njofton Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë.

5. Mosrespektimi i afateve, kur nuk përlligjet në mënyrën e duhur apo krijimi i qëllimshëm i pengesave për shkeljen e tyre, përbën shkak për marrjen e sanksioneve për personat përgjegjës.

Neni 7

Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me organet e njësive të qeverisjes vendore

1. Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me organet e njësive të qeverisjes vendore rregullohen me anë të marrëveshjeve të posaçme, të cilat nënshkruhen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe titullari i institucionit i cili kërkon asistencën juridike.
2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit harton një marrëveshje standard, e cila i propozohet organeve të njësive të qeverisjes vendore që kërkojnë asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit. Marrëveshja përcakton kushtet dhe kriteret e ofrimit të asistencës juridike nga Avokatura e Shtetit.
3. Në marrëdhëniet midis Avokaturës së Shtetit dhe organeve të njësive të qeverisjes vendore institucionet përfaqësohen nga titullarët e tyre. Të ardhurat eventuale të përfituara nga këto marrëveshje do të derdhen në buxhetin e Avokaturës së Shtetit.
4. Afatet, detyrimet për komunikim dhe procedura e ofrimit të asistencës juridike për organet e njësive të qeverisjes vendore të cilat kanë lidhur marrëveshje me Avokaturën e Shtetit janë të njëjta me ato të përshkruara në këtë rregullore për institucionet shtetërorë dhe entet publike.
5. Për çdo marrëveshje, sipas këtij neni, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit përcakton një avokat shteti koordinator, i cili do të përgjigjet për ndjekjen e saj.

Neni 8

Informimi dhe autorizimet paraprake

1. Në përfundim të procedurës pranë çdo shkalle gjykimi, avokati i shtetit i ngarkuar me përfaqësimin, informon me shkrim Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe titullarin e institucionit shtetëror apo të entit publik të përfaqësuar.
2. Ky informim përmban të dhëna mbi vendimin e gjykatës, pasojat juridike që burojnë nga vendimi, si edhe propozimin për ndërmarrjen ose jo të veprimeve procedurale aktive të mëtejshme.
3. Institucioni shtetëror ose enti publik vendos lidhur me propozimin për ndërmarrjen ose jo të veprimeve procedurale aktive të mëtejshme. Në rastet kur propozimi është bërë nga avokatët e shtetit i kërkon Avokaturës së Shtetit kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse, sipas një procedure të njëjtë me atë të parashikuar në këtë rregullore për fillimin e procedurave administrative dhe/ose ligjore.

Neni 9

Nisma për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore

1. Avokatura e Shtetit ka të drejtë të fillojë procedurat për paraqitjen e ankimit administrativ, të kërkesëpadisë, të kundërpadisë, të kërkesës për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë apo çdo veprimi procedural të ngjashëm vetëm me kërkesë me shkrim të institucionit shtetëror ose entit publik të interesuar, me përjashtim të rasteve urgjente.

2. Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar të organit të interesuar, ka të drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik, që tjetërson ose disponon pasurinë shtetërore, në favor të të tretëve, ose për shpërblimin e dëmtit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit ose për pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë ose me çdo objekt tjetër për mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit.

3. Avokatura e Shtetit, përpara depozitimit të padisë në gjykatë, i paraqet organit të interesuar një raport të hollësishëm me shkrim për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm/të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror/jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Ky raport mbyllet me qëndrimin e shprehur të Avokaturës së Shtetit për ngritjen ose jo të padisë.

4. Në rastet urgjente, Avokatura e Shtetit njofton menjëherë institucionin e interesuar dhe brenda 30 ditëve nga fillimi i procedurave administrative dhe/apo gjyqësore i paraqet raportin e hollësishëm sipas pikës 3 të këtij neni. Organi i interesuar, me marrjen e njoftimit dhe të raportit të hollësishëm, miraton ose jo veprimet e kryera dhe jep pëlqimin me shkrim për vazhdimin ose jo procedurës së filluar.

5. Në rast se institucioni shtetëror apo enti publik fillon procedurat ankimuese administrative apo gjyqësore me nismën e vet, atëherë ai ka detyrimin për të njoftuar paraprakisht me shkrim Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit.

Neni 10

Ankimet

Avokatët e Shtetit apelojnë ose paraqesin rekurs për të gjitha ato vendime që dëmtojnë të drejtat ose interesat e institucioneve shtetërore dhe enteve publike të asistuar prej tyre, përveç rasteve kur organi i interesuar iu kërkon me shkrim të kundërtën.

KREU III

KONTRAKTIMI I AVOKATËVE NË PROFESION TË LIRË NGA AVOKATURA E SHTETIT

Neni 11

Kontraktimi i avokatëve me profesion të lirë

1. Në çështje të rëndësishme për interesat e shtetit ose kur natyra e çështjes kërkon juristë të specializuar në fusha të veçanta, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me miratimin e Ministrit të Drejtësisë, kontraktin avokatë ose zyra avokatie në profesion të lirë, vendase ose të huaja, që do të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e shtetit shqiptar.

Neni 12

Kriteret dhe fillimi i procedurës së kontraktimit

1. Kriteret për kontraktimin e avokatëve me profesion të lirë janë:

- a) çështja është me rëndësi të veçantë për interesat e shtetit;
- b) çështja ka një natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë të caktuar;
- c) nuk ka ekzistuar një praktikë juridike e mëparshme nga Avokatura e Shtetit;
- ç) çështja ka si objekt dëmshpërblimin për shuma më të mëdha se 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë;
- d) në raste të tjera të veçanta të çmuara nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

2. Në çdo rast, për fillimin e procedurës Avokati i Përgjithshëm i Shtetit duhet të argumentojë nevojën e kontraktimit të avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja dhe të marrë paraprakisht mendimin e organit të administratës shtetërore apo entit publik, që është palë në gjykim, duke arsyetuar rëndësinë e çështjes apo veçantinë e saj.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i paraqet Ministrit të Drejtësisë kërkesën me shkrim, në të cilën motivon nevojën për kontraktimin e avokatëve me profesion të lirë për shkak të rëndësisë dhe natyrës së çështjes. Ai i bashkëngjit kësaj kërkesë edhe një kopje të mendimit paraprak të organit të administratës shtetërore apo entit publik.

4. Ministri i Drejtësisë shprehet lidhur me kërkesën brenda 5 ditëve nga marrja e saj. Në rast se Ministri i Drejtësisë nuk përgjigjet brenda këtij afati, kërkesa konsiderohet e miratuar.

Neni 13

Procedura e kontraktimit

1. Pas miratimit të kërkesës nga Ministri i Drejtësisë, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr urdhër për fillimin e procedurave për kontraktimin e avokatëve apo zyrave të avokatisë, vendase ose të huaja, duke përcaktuar, për çdo rast, nevojën e kontraktimit, kushtet e veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, objektin e punës/llojet e shërbimeve të kërkuara, si dhe përbërjen e komisionit për ndjekjen e procedurave.

2. Në varësi të çështjes për të cilën kërkohet mbrojtja apo përfaqësimi, kriteret e përgjithshme, për përzgjedhjen e avokatëve apo zyrave të avokatisë, janë:

a) vendi i ushtrimit të aktivitetit duhet të jetë i njëjtë me atë të selisë së organit pranë të cilit kryhet përfaqësimi;

b) specialiteti i avokatit/ zyrës së avokatisë në fushën e objektit të çështjes për të cilën është vendosur fillimi i procedurës së kontraktimit;

c) numri i çështjeve të fituara në procedime të ngjashme;

ç) besueshmëria dhe reputacioni.

Neni 14

Detyrat e komisionit të procedurave

1. Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumentacionit përkatës përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët caktohen në urdhrin për fillimin e procedurave për kontraktimin.

2. Komisioni, brenda 5 ditëve nga data e daljes së urdhrin, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, avokatëve apo zyrave të avokatisë, vendase apo të huaja, ftesën për negociata. Ftesa për negociata publikohet edhe në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

3. Ftesa për negociata duhet të përmbajë specifikimin e objektit dhe llojit të shërbimit të kërkuar, nevojën e kontraktimit të avokatëve apo zyrave të avokatisë, vendase apo të huaja, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, dhe datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit.

4. Komisioni pret konfirmimin nga avokatët apo zyrat e avokatisë, për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata. Konfirmimi për vazhdimësinë e negociatave shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit apo mbrojtjes. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit në një ditë të vetme.

5. Pas analizimit të ofertave të paraqitura nga avokatët apo zyrat e avokatisë, vendase apo të huaja, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, avokatin apo zyrën e avokatisë, vendase apo të huaj, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 13 dhe në ftesën për negociim.

6. Brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë dhe avokatin/ zyrën e avokatisë së përzgjedhur, të cilin ia paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit së bashku me klasifikimin përfundimtar të avokatëve/zyrave të avokatisë sipas pikëve.

7. Avokati i Përgjithshëm, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit dhe ia dërgon vendimin e tij për miratim Ministrit të Drejtësisë, duke njoftuar njëkohësisht avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë, si dhe organin e përfaqësuar.

8. Organi i përfaqësuar mund të paraqesë me shkrim brenda tri ditëve te Ministri i Drejtësisë kundërshtimet e veta në lidhje me çmimin e shërbimit. Në rast se organi i përfaqësuar nuk paraqet kundërshtime me shkrim brenda këtij afati, çmimi i shërbimit konsiderohet i pranuar prej tij.

Neni 15

Miratimi i kontraktimit

1. Avokatët apo zyrat e avokatisë të interesuara mund të ankohen lidhur me procedurën e kontraktimit brenda 5 ditëve nga vendimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Ankesat për procedurën e kontraktimit paraqiten në çdo rast me shkrim dhe i drejtohen Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë shprehet me vendim lidhur me ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e saj dhe njofton ankuesin dhe Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit me shkrim.

2. Në përfundim, Ministri i Drejtësisë brenda 7 ditëve nga paraqitja e vendimit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit miraton kontraktimin e avokatit/zyrës së avokatisë. Në rast se Ministri i Drejtësisë nuk përgjigjet brenda këtij afati, vendimi i kontraktimit konsiderohet i miratuar. Në vijim, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lidh kontratën me avokatin apo zyrën e avokatisë, vendase apo të huaj, për kryerjen e shërbimit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes.

3. Avokati i Përgjithshëm përcakton një avokat shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me subjektin e përzgjedhur. Pas lidhjes së kontratës, sipas kësaj pike, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr masa për të pajisur avokatin/zyrën e avokatisë së përzgjedhur me autorizimin përkatës nga ana e titullarit të institucionit shtetëror ose entit publik të interesuar.

KREU IV

KONTRAKTIMI I AVOKATËVE NË PROFESION TË LIRË KUR ASISTENCA JURIDIKE KËRKOHEK NGA ORGANI I ADMINISTRATËS PUBLIKE APO ENTIT PUBLIK

Neni 16

Kontraktimi i avokatëve në profesion të lirë

1. Organi i administratës publike apo entit publik, kur ka nevojë të asistohet në veprimtarinë juridike, veçanërisht në procesin e lidhjes së kontratave, kërkon mendim këshillimor me shkrim nga Avokatura e Shtetit.
2. Kur Avokatura e Shtetit deklaron me shkrim se nuk është në gjendje që të ofrojë asistencë juridike për këtë rast, atëherë organi administrates shtetërore ose entit publik fillon procedurat e parashikuara në nenin 17 për kontraktimin e avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë.

Neni 17

Kushtet për fillimin e procedurës së kontraktimit të avokatëve në profesion të lirë

1. Fillimi i procedurës së parashikuar në pikën 2 të nenit 16 bëhet kur:
 - a) çështja është me rëndësi të veçantë për interesat e shtetit;
 - b) çështja ka një natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në fushë të caktuar;
 - c) çështja ka vlerë objekti shuma më të mëdha se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
 - ç) në raste të tjera të veçanta të çmuara nga organi i administratës publike apo entit publik.
2. Për fillimin e procedurës, titullari i organit të administratës publike apo entit publik me kërkesë drejtuar Avokaturës së Shtetit duhet të argumentojë nevojën e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë, vendase ose të huaja, duke arsyetuar rëndësinë e çështjes dhe veçantinë e saj.
3. Avokatura e Shtetit pasi shqyrton rastin, i paraqet Ministrin të Drejtësisë kërkesën me shkrim, në të cilin motivon nevojën e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë për shkak të rëndësisë dhe natyrës së çështjes. Kërkesës së Avokaturës së Shtetit i bashkëngjitet edhe kërkesa e titullarit të administratës publike apo entit publik.

Neni 18

Procedura e kontraktimit

1. Pas miratimit të kërkesës, Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhër për fillimin e procedurave për kontraktimin e avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë, duke përcaktuar, për çdo rast, nevojën e kontraktimit, kushtet e veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, objektin e punës/llojet e shërbimeve të kërkuara, si dhe përbërjen e komisionit për ndjekjen e procedurave.

2. Në varësi të çështjes për të cilën kërkohet këshillimi, kriteret e përgjithshme, për përzgjedhjen e avokatëve apo zyrave të avokatisë, janë:

- a) specialiteti i avokatit/ zyrës së avokatisë në fushën ku kërkohet këshillimi juridik;
- b) përvoja në fushën e këshillimit;
- c) besueshmëria dhe reputacioni.

Neni 19

Detyrat e komisionit të procedurave

1. Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumentacionit përkatës përbëhet nga 3 anëtarë të cilët caktohen në urdhrin për fillimin e procedurave për kontraktimin.

2. Komisioni, brenda 5 ditëve nga data e daljes së urdhrin, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë ftesën për negociata. Ftesa për negociata publikohet edhe në faqen zyrtare të organit të administratës publike apo entit publik.

3. Ftesa për negociata duhet të përmbajë specifikimin e objektit dhe llojit të shërbimit të kërkuar, nevojën e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, dhe datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit.

4. Komisioni pret konfirmimin nga avokatët/zyrat e avokatisë në profesion të lirë, për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata. Konfirmimi për vazhdimësinë e negociatave shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e shërbimeve të këshillimit. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit në një ditë të vetme.

5. Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga avokatët/zyrat e avokatisë, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, avokatin apo zyrën e avokatisë, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në nenin 18 dhe në ftesën për negociim.

6. Brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë dhe avokatin/ zyrën e avokatisë së përzgjedhur, të cilin ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, së bashku me klasifikimin përfundimtar të avokatëve/zyrave të avokatisë sipas pikëve. Ky raport i njoftohet njëkohësisht avokatëve/zyrave të avokatisë që kanë marrë pjesë, si dhe organit shtetëror që kërkon kontraktimin.

Neni 20

Miratimi i kontraktimit

1. Avokatët/zyrat e avokatisë të interesuara apo organi shtetëror që kërkon kontraktimin mund të ankohen lidhur me procedurën e përzgjedhjes brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit. Ankesat paraqiten në çdo rast me shkrim dhe i drejtohen Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë shprehet me vendim lidhur me ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e saj, dhe njofton ankuesin dhe titullarin e organit të administratës publike apo entit publik me shkrim.

2. Në përfundim, Ministri i Drejtësisë brenda 7 ditëve nga paraqitja e raportit prej komisionit vleftëson procedurën e përzgjedhjes dhe njofton organin e administratës shtetërore apo entin publik për kontraktimin e avokatit/zyrës së avokatisë. Në rast se Ministri i Drejtësisë nuk përgjigjet brenda këtij afati, procedura e përzgjedhjes konsiderohet e vlefshme. Në vijim, titullari i organit të administratës publike apo entit publik lidh kontratën me avokatin apo zyrën e avokatisë, për kryerjen e shërbimit të këshillimit.

3. Titullari i organit të administratës publike apo entit publik përcakton një nëpunës të profilit jurist për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me subjektin e përzgjedhur.

KREU V

PROCEDURAT E POSAÇME PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË AVOKATËVE TË SHTETIT DHE ROLI I AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM

Neni 21

Përfaqësimi

1. Interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave shqiptare, ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe organeve të tjera në çështjet gjyqësore në të cilat një institucion shtetëror, ent publik ose Republika e Shqipërisë është palë përfaqësohen dhe mbrohen nga Avokatura e Shtetit.

2. Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar në nivelin qendror të Avokaturës së Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës.

3. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare në nivelin qendror në Avokaturën e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese.

4. Avokatët e shtetit pranë ministrive përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në çështjet gjyqësore:

a) të cilat kanë për objekt mbrojtjen e interesave pasurore të ministrive, pranë të cilave janë emëruar;

b) të cilat kanë për objekt mbrojtjen e interesave pasurore të institucioneve në varësi të ministrive, pranë të cilave janë emëruar;

c) të cilat kanë objekt të ngjashëm me fushën e ministrisë, pranë së cilës ushtron veprimtarinë. Në këtë rast të fundit, avokati i shtetit caktohet për të përfaqësuar dhe mbrojtur organin e interesuar me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

5. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat pasurore të shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në çështjet të cilat kanë objekt të ndryshëm nga ai i parashikuar, më sipër.

Neni 22

Procedurat e zakonshme

Avokatura e Shtetit ndjek procedurat e parashikuara ligjore në të gjitha rastet e dhënies së asistencës juridike për institucionet shtetërore.

Neni 23

Procedura e këshillimit

1. Në të gjitha rastet e dhënies së asistencës juridike nëpërmjet këshillimit juridik, Avokatura e Shtetit ndjek procedurat e përcaktuara ligjore dhe ato në këtë rregullore.

2. Përjashtimisht, mbi bazën e një akti administrativ të arsyetuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me miratimin e Ministrit të Drejtësisë, Avokatura e Shtetit mund të ofrojë konsulencën juridike me procedurë të ndryshme sipas aktit të miratuar në përputhje me këtë nen.

Neni 24

Procedura e përfaqësimit

1. Në rastet e përfaqësimit dhe/apo mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, Avokatura e Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, Avokatura e Shtetit respekton rregullat për marrjen e kërkesës së motivuar nga organi i interesuar për t'u përfaqësuar në gjykim, pa qenë e nevojshme marrja e një autorizimi të posaçëm të të përfaqësuarit.
2. Avokatura e Shtetit mund të kryejë procedura të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore, kur është në interes të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe me miratim të institucionit të interesuar, por gjithmonë duke respektuar dispozitat ligjore procedurale.
3. Në çdo rast, Avokatura e Shtetit në përpilimin e akteve drejtuar organeve gjyqësore respekton kërkesat formale të legjislacionit procedural.

Neni 25

Mbrojtja e interesave të shtetit

Avokatët e shtetit, gjatë përfaqësimit të institucioneve shtetërore, mbrojnë interesat e institucionit që përfaqësojnë gjatë të gjitha fazave procedurale që marrin pjesë.

KREU VI

RASTET DHE ÇËSHTJET E USHTRIMIT TË KËSHILLIMIT TË INSTITUCIONEVE

Neni 26

Rastet/ llojet e këshillimit

1. Institucionet shtetërore dhe entet publike në përputhje me parashikimet ligjore, në rast se iu lind e nevojshme gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, mund të kërkojnë nga Avokatura e Shtetit mendim me shkrim për çështje të karakterit juridik, të cilat mund të prodhojnë pasoja ekonomiko-financiare për shtetin, veçanërisht për kontratat dhe veprimet juridike të cilat

parashikojnë detyrime. Të drejtën për këshillim, në këto raste, e ka ekskluzivisht Avokatura e Shtetit.

2. Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave administrative, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, këshillimi i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm.

3. Nëse gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, avokatët e shtetit, marrin dijeni për akte apo veprime të institucioneve shtetërore ose enteve publike, të cilat bien ndesh me kriteret e vendosura nga Avokatura e Shtetit apo me praktikën gjyqësore të unifikuar, mund t'ia bëjnë të ditur atë në mënyrë të arsyetuar organit të interesuar, si dhe vetë Avokaturës së Përgjithshme. Në këtë rast njoftimi me shkrim i drejtohet titullarit të institucionit të interesuar, Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, si dhe nënshkruhet nga titullari i zyrës përkatëse të Avokaturës së Shtetit.

Neni 27

Kërkesa për këshillim

1. Funksioni këshillimor në rastin e ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre realizohet nëpërmjet avokatëve të shtetit pranë ministrisë përkatëse, të cilëve iu vihen në dispozicion të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e nevojshme që lidhen me çështjen objekt këshillimi duke u krijuar gjithashtu edhe lehtësitë e nevojshme për ushtrimin e këtij funksioni.

2. Entet publike, si dhe organet e njësisve të qeverisjes vendore të cilat kanë marrëveshje të posaçme me Avokaturën e Shtetit, i drejtojnë kërkesë për këshillim Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit nëpërmjet titullarit të tyre.

3. Kërkesa për këshillim, në çdo rast, duhet të jetë e arsyetuar dhe e shoqëruar me të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e nevojshme që lidhen me çështjen objekt këshillimi.

Neni 28

Shërbimi këshillimor i Avokaturës së Shtetit

1. Avokatura e Shtetit, në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të shtetit, bazuar vetëm në një analizë të mirëfilltë juridike të çështjes, objekt këshillimi dhe të pasojave juridike, që mund të vijnë prej saj, u jep mendim me shkrim organeve të administratës publike. Në rastet e shërbimit këshillimor në procedurat e lidhjes së kontratave, mendimi i avokaturës konsiston veçanërisht në drejtim të ligjshmërisë së formës dhe të përmbajtjes së kontratës, në drejtim të zgjedhjes më oportune në rastin e disa zgjedhjeve, si dhe në drejtim të formulimeve konkrete të pjesëve të veçanta të kontratës.

2. Mendimi i avokaturës konsiston, kryesisht për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr një çështje në gjykim. Ky mendim mund të jetë edhe sugjerim për procedimet administrative, me natyrë konfliktuale, të cilat mund të bëhen shkak për lindjen e konflikteve gjyqësore. Në asnjë rast, këshillimi nuk mund të jetë vlerësim mbi qëllimin e nxjerrjes së aktit juridik.

3. Avokatura e Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit këshillues, mund të kërkojë plotësimin e informacionit apo dokumentacionit të paraqitur nga organet e administratës publike apo mund të kërkojë informacione apo dokumente shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme. Institucionet shtetërore ose entet publike detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit çdo sqarim, informacion apo dokumentet e kërkuara, brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës prej kësaj të fundit.

Neni 29

Procedura e këshillimit

1. Në rastet kur kërkohet këshillimi, titullari i institucionit të interesuar paraqet kërkesë me shkrim, për këtë qëllim, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit ose avokatit të shtetit pranë ministrive.

2. Kur kërkuese është një ministri, pranë të cilës është i emëruar një avokat shteti, kërkesa i drejtohet drejtpërdrejt këtij të fundit. Në rast të kundërt kërkesa i drejtohet Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

3. Kërkesa shoqërohet me kopje të praktikës për të cilën kërkohet këshillimi, si edhe me çdo lloj dokumentacioni tjetër ndihmës, i cili mund të shërbejë për njohjen e plotë të çështjes objekt këshillimi. Në kërkesë përcaktohet edhe një afat gjer në dhjetë ditë, brenda të cilit kërkohet mendimi këshillimor i Avokaturës së Shtetit.

4. Avokatura e Shtetit/avokati i shtetit jep mendim brenda afatit të kërkuar, të specifikuar në kërkesë, me përjashtim të rasteve kur për shkak të kompleksitetit të çështjes është i nevojshëm një afat më i gjatë, i cili në çdo rast mund të zgjatet vetëm një herë gjer në 10 ditë përtej afatit fillestar të specifikuar në kërkesën për këshillim. Në këtë rast Avokatura e Shtetit njofton me shkrim, titullarin e institucionit, i cili kërkon këshillimin, si dhe Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, duke dhënë motivet për shtyrjen e afatit, si edhe afatin e ri të propozuar.

5. Mendimi i Avokaturës së Shtetit/avokatit të shtetit pranë ministrisë, mbi praktikën këshillimore, jepet në çdo rast me shkrim, dhe bëhet pjesë e praktikës për të cilën kërkohet këshillimi.

6. Funksionet këshillimore të kryera nga avokatët e shtetit pranë ministrive mbikëqyrën nga zyra e këshillimit dhe e koordinimit ndërministror në nivelin qendror të Avokaturës së Shtetit.

Neni 30

Efektet e këshillimit

1. Mendimi këshillimor i dhënë nga Avokatura e Shtetit, nuk ka karakter detyrues për organin e administratës publike, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.
2. Mendimi këshillimor i dhënë nga Avokatura e Shtetit i drejtohet ekskluzivisht organit të administratës publike apo entit publik, që e ka kërkuar dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret si provë në gjykim.
3. Në rastet kur mendimi këshillimor i dhënë nga avokati i shtetit pranë ministrisë dhe kërkuesi i këshillimit, që sipas rastit është ministria apo institucioni në varësi të saj, nuk është dakord me mendimin e dhënë dhe e vlerëson të nevojshme, i dërgon çështjen objekt këshillimi të shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit merr opinionin e zyrës së këshillimit dhe të koordinimit ndërministror në nivelin qendror të Avokaturës së Shtetit dhe jep mendimin përfundimtar, me shkrim, duke respektuar parimin e unitetit të doktrinës.
4. Avokatët e shtetit pranë ministrive, mendimi këshillimor i të cilëve për çështje të njëjta ose të ngjashme nuk merret parasysh në disa raste, i drejtohen Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për unifikimin e doktrinës lidhur me çështjen.
5. Organi i administratës publike apo enti publik, pavarësisht karakterit jodetyrues të mendimit të Avokaturës së Shtetit duhet të motivojë në një akt të shkruar veprimin ndryshe nga mendimi këshillues i Avokaturës, i cili bëhet pjesë e praktikës përkatëse objekt këshillimi.
6. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me kërkesë të motivuar të avokatëve/ zyrave të avokaturës së shtetit ose kryesisht, në varësi të kompleksitetit dhe rëndësisë së çështjeve, vepron në bazë të praktikës së njehsuar juridike duke formuluar kritere të përgjithshme të asistencës juridike për Avokatët e Shtetit.

KREU VII

DELEGIMI I TË DREJTËS SË PËRFAQËSIMIT DHE TË MBROJTJES

Neni 31

Delegimi i përfaqësimit dhe i mbrojtjes

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kryesisht ose me propozim të avokatit të shtetit/zyrës së avokaturës së shtetit të caktuar për përfaqësimin e një çështjeje, mund ta delegojë të drejtën e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim te organi i interesuar i administratës publike.

2. Delegimi bëhet në çdo rast me shkrim dhe i motivuar.

Neni 32

Kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes

Delegimi i të drejtës së përfaqësimit në gjykim, nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) Kur avokati i shtetit pranë ministrive nuk ka dhënë mendim lidhur me aktin/ pasojat e aktit objekt gjykimi;

b) Kur avokati i shtetit pranë ministrive ka dhënë mendim pjesërisht apo tërësisht të ndryshëm në lidhje me aktin/ pasojat e aktit objekt gjykimi;

c) Kur delegimi i të drejtës së përfaqësimit vlerësohet i mundshëm në bazë të kriterëve të njehsimit të praktikës të përpunuara nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

ç) Kur vlera e objektit të padisë së çështjes objekt gjykimi është më e vogël se 2 000 000 (dy milionë) lekë;

d) Kur objekt gjykimi janë marrëdhëniet e punës ndërmjet institucioneve dhe personave të tretë, pavarësisht pikës d të këtij neni;

dh) Në rastet e mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit në gjykimin penal kur vlera e dëmit material është me vogël se një milion lekë;

e) Kur sipas statistikave ka një numër të konsiderueshëm çështjesh të ngjashme nga i njëjti institucion dhe praktika juridike është njehsuar.

Neni 33

Detyrimi i pranimit të delegimit

Organi i administratës publike apo enti publik, të cilit i delegohet e drejta e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim, nuk mund ta refuzojë përfaqësimin, me përjashtim të rasteve të konfliktit të interesit. Konflikti i interesit për përfaqësim i njoftohet menjëherë me shkrim, Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe titullarit të institucionit përkatës.

KREU VIII

SHPENZIMET E PROCESIT

Neni 34

Tarifat gjyqësore, depozitat, garancitë

1. Për ushtrimin e funksioneve të saj Avokatura e Shtetit përjashtohet nga detyrimi për pagesën e tarifave gjyqësore dhe për veprimet e shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore, prokuroria dhe përmbaruesi gjyqësor sipas parashikimeve ligjore.
2. Në rastet kur për efekte të mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim kërkohet krijimi i depozitave, garancive, dorëzanive apo pagesave të ngjashme, shpenzimet për këtë qëllim mbulohen nga buxheti i institucionit shtetëror të interesuar.

Neni 35

Pagesat për kontraktimin e shërbimeve të përfaqësimit dhe të konsulencës

1. Në rastet e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatëve në profesion të lirë sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore, pagesat në lidhje me shpenzimet procedurale në gjykim, në një gjykatë vendase ose të huaj, dhe arbitrazh ndërkombëtar, pagesat e arbitrave, avokatëve të huaj, ekspertëve, përkthimeve, duhet të kryhen nga ana e organit të interesuar të administratës ose institucionit publik brenda afatit të përcaktuar për këtë qëllim nga Avokatura e Shtetit në komunikimin zyrtar.
2. Avokatura e Shtetit merr përsipër monitorimin e shpenzimeve procedurale të avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë. Organi i interesuar i administratës ose institucioni publik i interesuar do të kryejë këto pagesa, pasi të jenë miratuar paraprakisht nga avokati i shtetit, i caktuar për ndjekjen e çështjes dhe nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.
3. Pagesa sipas parashikimeve të këtij neni kryhet në llogarinë bankare të avokatëve/zyrave të avokatisë, sipas përcaktimeve të specifikuara në kontratën e lidhur për këtë qëllim me Avokaturën e Shtetit, si edhe në llogarinë e të tretëve të cilët mund të kenë parapaguar pjesërisht ose tërësisht shpenzimet.

Neni 36

Efektet ekonomike të procesit

1. Kur vendimi i gjykatës përcakton detyrimin në ngarkim të palës kundërshtare në një proces për të paguar shpenzimet gjyqësore, në rastet e çështjeve të ndjekura nga Avokatura e Shtetit, shuma në fjalë, pa prekur efektet ekonomike të procesit, do të transferohet në buxhetin e Avokaturës së Shtetit.
2. Kur vendimi i gjykatës përcakton detyrimin në ngarkim të organit të administratës publike ose institucionit shtetëror për të paguar shpenzimet gjyqësore, ato do të mbulohen nga buxheti i organit të administratës ose institucionit shtetëror të interesuar në rast se nuk ka një marrëveshje të kundërt për këtë qëllim midis Avokaturës së Shtetit dhe organit të cilit i ofrohet asistenca juridike.
3. Për përcaktimin e masës së shpenzimeve të procedurës, për rastet e mësipërme, zbatohen kriteret e përgjithshme të legjislacionit procedural.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 37

Përfaqësimi për çështjet në gjykim deri në kohën e hyrjes në fuqi të rregullores

1. Përfaqësimi i Avokaturës së Shtetit në të gjitha proceset gjyqësore të nisura para hyrjes në fuqi të ligjit funksional dhe kësaj rregulloreje trajtohen sipas dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi në kohën e nisjes së tyre, por vetëm për gjykimin në atë shkallë në të cilën ndodhet çështja.
2. Çështjet gjyqësore në vijim, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, në të cilat institucionet shtetërore dhe entet publike janë palë, të cilat për shkak të vlerës dhe/ose objektit nuk kanë parashikuar pjesëmarrjen në gjykim të Avokaturës së Shtetit, do të vazhdojnë të ndiqen nga përfaqësuesit e institucioneve të interesuara, por vetëm për gjykimin në atë shkallë në të cilën ndodhet çështja.